



VENDIMI PËR SISTEMIN E RI TË RANKIMIT

Hyrje

Situata me Covid 19 ka krijuar pengesa në të gjitha sferat e jetës. Edhe tenisi është prekur nga kjo situatë. Aktivitetet e tenisit janë ndërprerë prej marsit 2020, ndërsa kanë rifilluar në masë të kufizuar në qershor 2020. Ndërsa turneu i parë është organizuar vetëm në fillim të korrikut 2020. Krahasuar me kalendarin e miratuar të garave në fillim të vitit, një numër i konsiderueshëm i turneve në kategori të ndryshme nuk ka mundur të organizohet, duke e bërë të pamundur vazhdimin sipas atij kalendarit. Me rihapjen pas periudhës së bllokimit, ky kalendar është rishikuar në bashkëpunim me klubet. Rankimi i cili publikohet në periudha javore, ka qenë i ngrirë që nga java 11 e këtij viti për shkak të ndërprerjes së garave. Situata e tillë ka krijuar nevojën që të rishikohet edhe sistemi i rankimit të tenisistëve për këtë vit. Një gjë e tillë është bërë edhe në nivel të tenisit ndërkombëtar. Ky ndryshim bëhet duke u bazuar në praktikën e krijuar në nivel të ITF-së, më saktësisht ATP-së, dhe rrethanat në nivel të Kosovës.

Ndryshimet në sistemin e rankingut:

1. Të vlejné pikët e turneve të fituara nga tenistët që nga turneu i parë i vitit 2019, duke llogaritur pikët e fituara gjatë 104 javëve të fundit.
2. Ndër këto rezultate, në rankim do të përfshihen rezultatet nga 6 turnetë ku tenisti ka fituar më së shumti pikë.
3. Për tenistin që ka ndërruar grupmoshën, në përzgjedhjen e 6 turneve për qëllime të pikës 2, prioritetet kanë turnetë e grupmoshës së re që tenisti i ka luajtur. Në rast se tenisti i ka luajtur më pak se 6 turne në grupmoshën e re, atëherë turnetë e mbetura plotësohen me turnetë e grupmoshës paraprake.
4. Për shkak të dallimit të madh në pikëzim në mes të kategorisë U16 dhe U 18, pika 3 e këtij propozimit, në rastin e kalimit prej kategorisë U16 në kategorinë U18, modifikohet si në vijim: Pikët e fituara vitin e kaluar në kategorinë U16 pjesëtohen me faktorin 14, për t'i bërë të përafërta pikët e të dyja kategorive.

Mërgime Mula,
Komisare e garave, FTK

Korrik, 2020